Në përcaktimin e numrit te punonjësve AK ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagen minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratësn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit te tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim te paktën **120 punonjes** duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj maksimumi 8 (tetë) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet

kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar dmosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **120 punonjës.**

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- **1** *(një)* **Inxhinier Ndertimi**
- **1** *(një)* **Inxhinier Ndertimi profili Strukturist**
- **1** *(një)* **Inxhinier Elektrik**
- **1** *(një)* **Inxhinier Mekanik**
- **1** *(një)* **Inxhinier Hidroteknik**
- **1** *(një)* **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- **1** *(një)* **Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion**
- **1** *(një)* **Inxhinier Mjedisi**
- **1** *(një)* **Inxhinier Gjeolog**

Njëri nga drejtuesit teknik duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjitik në Ndërtesa", lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë.

*(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)*

***Shënim:*** *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

***Argumentimi:*** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të lartëpërmendur, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **<u>drejtues teknik</u>** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohet se: "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit" dhe pika 2: "elementët e licensës" gërma "c" ku citohet se: "Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. <u>Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë.</u> Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose


Sheshi "Musa Fratari" Këlcyrë E-mail:bashkiaekelcyres@yahoo.com

ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë".

- **Inxhinier Ndertimi** është i nevojshëm si drejtues teknik në këtë objekt, pasi punimet përfshijnë një game të gjerë aktivitetesh ndërtimore të cilat kërkojnë koordinik të saktë teknik. Rikonstruksioni i plotë i godinës ekzistuese, punimet ndërtimore civile të palestrës (përveç punimeve strukturore dhe betonit), terrenet sportive, sistemimi i sheshit me pllaka guri dhe muri rrethues me gurë, kërkojnë kontroll të vazhdueshëm për të garantuar përputhjen me projektin, specifikimet dhe standartet e ndërtimit.
  Prania e tij siguron që punimet e shumta ndërtimore të zhvillohen në mënyrë të sigurt, në përputhje me kërkesa ligjore dhe teknike, duke garantuar funskionalitetin dhe cilësinë e përgjithshme të objektit.

- **Inxhinier Ndertimi profili Strukturist** është i nevojshëm në këtë objekt sepse ai garanton sigurinë dhe stabilitetin e strukturës mbajtëse mbi tokë (palestrën e re me ambjentet ndihmëse dhe shkallën e emergjencës), që përfshin elemente të kombinuar betoni dhe çeliku. Ky profil është përgjegjës për mënyrën se si ngarkesat shpërndahen dhe transferohen nga konstruksioni metalik në bazamentet e betonit, duke llogaritur ndikimet e forcave dinamike apo dhe vibrimet që krijohen gjatë aktivitetit të përditshëm.

- **Inxhinier Elektrik** është i nevojshëm pasi ai garanton që të gjitha instalimet të realizohen sipas standarteve të sigurisë elektrike. Duke qenë se në objekt përfshihen instalimet e ndriçimit, rrjetet e shpërndarjes së energjise, sistemi i fuqisë, sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit dhe rrufepritësit, inxhinieri elektrik është përgjegjës për verifikimin e zbatimit korrekt të këtyre elementeve, për kontrollin e lidhjeve, mbritjeve dhe dimensioneve të përçuesve, si dhe testimin e funksionalitetit dhe sigurisë së qarkut elektrik përpara vënies në pune.

- **Inxhinier Mekanik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku perfshihet komplet sistemi i ngrohjes dhe sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit MNZ sipas parashikimeve në relacionin për mbrojtjen nga zjarri,

- **Inxhinier Hidroteknik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike/punimeve të ngrohjes duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e tubave dhe rakorderive, pajisjeve hidrosanitare (WC, lavaman, rubineteri etj), furnizimin e ujit sanitar, sistemin MNZ, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder** eëhtë i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rilevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme, përsa i përket sistemimit të terreneve të jashtme, si dhe të ndërtimit të palestrës nga e para.

- **Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion** është i nevojshëm sepse punimet që do të kryhen përfshijnë instalime të rrjeteve kompjuterike, sistemeve të kamerave të sigurisë, sinjalistikës së emergjencës dhe alarmit të zjarrit (digjitale/analoge), të cilat kërkojnë njohuri të specializuara për sinjalet elektrike, komunikimin dixhital dhe sistemet e rrymave të ulëta. Ky profil është përgjegjës për zbatimin dhe testimin e rrjetit (kabllot F/FTP, patch panelet, rack-et dhe switchet. Po ashtu ky inxhinier merret me mbarëvajtjen e proçesit të instalimit dhe konfigurimit të kamerave IP në përputhje me normat SSH EN 50130-4, si dhe zbatimin e sistemeve të alarmit të zjarrit sipas standartit SSH EN 54.

- **Inxhinier Mjedisi** është i nevojshëm në fazën e zbatimit të këtij objekti pasi punimet për rikonstruksionin e shkollës, ndërtimit të palestrës dhe terreneve sportive, përfshijnë proçese që ndikojnë drejtperdrejtë në mjedis dhe kërkojnë kontroll të kujdesshëm për të shmangur ndotjen dhe dëmtimet në zonën perreth. Ai siguron që gjatë zbatimit të respektohen rregullat për menaxhimin e mbetjeve ndërtimore, kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe ujërave të ndotura, duke mbajtur nën mbikqyrje mënyrën se si trajtohen mbetjet inerte dhe materialet e riciklueshme.

- **1 *(një)* Inxhinier Gjeolog** Lidhur me kërkesën mbi disponimin si drejtues teknik edhe të një ing. Gjeolog, referuar objektit të kontratës, ku ky i fundit shprehet se "Ing. Gjeolog është vendosur pasi, në objektin ku do të zhvillohet investimi do të hapen themelet nga e para për të ndërtuar palestrën do të duhet edhe mendimi i specializuar i këtij inxhinieri gjeolog si Drejtues Teknik në stafin e një shoqërie ndërtimi, e cila është e nevojshme për realizimin me sukses të punës, për sa kohë që ajo është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

***Lidhur me kërkesën se njeri prej inxhinierëve të sipërcituar duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjitik në Ndërtesa", lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, njësia e prokurimit argumenton se ;***

**Argumentimi :** Kërkesa e shkronjës e) është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma "b" të ligjit nr. 124/2015 "*Për efiçencën e energjisë*" i ndryshuar, ku parashikohet se "Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen :

- *çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo* ***i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm*****"**,

si dhe bazuar në VKM nr. 407, datë 19.06.2019 *"Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet Certifikata e Audituesit Energjitik",* ku parashikohet se: *a) "Certifikatë e audituesit energjetik", certifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri.*

Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime të cilat lidhen me efiçencën e energjisë si sistemi i ngrohjes, qarkullimi i ajrit, izolimi akustik, hidrik dhe termik jemi në kushtet që disponueshmëria e një auditesi energjie në bazë të VKM Nr. 407 datë 19.06.2019, është i domosdoshëm.

Për objektin konkret, në fazën e projektimit nuk është hartuar raporti paraprak i eficencës së energjisë dhe rrjedhimisht është i domosdoshëm Audituesi i Energjisë në fazën e zbatimit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021**, i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit.*

**2.3.5** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin inxhinierik të kualifikuar** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1** *(një)* **Inxhinier Gjeoteknik**
- **1** *(një)* **Arkitekt**
- **1** *(një***)** **Inxhinier Perpunim Druri**

*Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për* ***3 muajit*** *e fundit.*

*(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)*

***Shënim:**Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

***Argumentimi:*** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik",* Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme prania e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

- **Inxhinier Gjeoteknik** është i nevojshëm pasi kushtet e terrenit në këtë zonë janë thelbësore për sigurinë dhe qendrueshmërinë e strukturës (ndërtimi i palestrës së re me ambjentet ndihmëse). Duke qenë se zona është me shtresa tokë të përziera – argjilore dhe me fragmente shkëmbore, gjë që kërkon një vlerësim të kujdesshëm të kapacitetit mbajtës dhe stabilitetit të terrenit. Inxhinieri Gjeoteknik garanton që zbatimi i themeleve të betonit të kryhet duke verifikuar gjendjen reale të tokës gjatë gërmimit dhe duke përcaktuar nëse kërkohen masa shtesë si stabilizimi, drenazhi ose zëvendësimi i shtresave, pasi çdo ulje diferenciale mund të ndikojë në stabilitetin e përgjithshëm të strukturës.
  Inxhinieri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të materialeve që do të përdoren për nënshtresë zhavori, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për plintat e themelit dhe për materialet e betoneve te tjera. Projekti zbatohet mbi formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizen e inxhinierit të sipërcituar. Bazuar në hartën e re sizmike ku i gjithë territori i Shqipërisë konsiderohet me sizmicitet të lartë, kujdesi dhe nevoja për staf të kualifikuar aq më tepër për stafin tekniko – inxhinierik si Inxhinieri Gjeoteknik është evidente. Pasi bëhet inspektimi në vend si dhe provat laboratorike, i propozohen mbikqyrësit të punimeve Mix – Design e Betoneve. Një rëndësi të madhe do të ketë prezenca e tij gjatë ndërtimit të shtresave të terreneve dhe themeleve të rrethimit të shkollës

- **Arkitekt** eshte i nevojshem ne fazen e zbatimit si pjese e stafit mbeshtetes, pasi siguron qe punimet te kryhen ne perputhje me projektin arkitektonik te miratuar dhe me kerkesat funksionale e estetike te godines. Ai mbikqyrë dhe miraton perdorimin e materialeve, ngjyrave dhe detajeve perfundimtare, duke garantuar cilesi vizuale dhe koherence me projektin e shkolles dhe palestres.
  Arkitekti është vendosur si kriter pasi është e nevojshme për të udhëhequr dhe realizuar me cilësi punimet e rifiniturës, suvatim të jashtëm, elementet dekorativë, veshjet me pllaka majolike, cilësinë e lyerjeve, ngjyrat, fasadat etj.
  Punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, përkojnë plotësisht me arkitektin e kërkuar nga njësia e prokurimit. Në këtë kuptim referuar vlerës së kontratës, kohëzgjatjes si dhe natyrës së punimeve të përcaktuara në preventiv është më se e mjaftueshme për realizimin me sukses të objektit disponimini i një arkitekti nga operatori ekonomik fitues i kësaj procedure prokurimit . Arkitekti do të jetë i nevojshëm për të udhëhequr të gjithë punën nga fillimi deri në fund duke ju përmbajtur me rigorozitet “Preventivin e punimeve”,“Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik për objektin e kontratës.

- **Inxhinier Perpunim Druri** është i nevojshëm për shkak të punimeve që përfshijnë përdorimin, përpunimin dhe montimin e elementeve drusore dhe paneleve të përbëra, si parketi, shirit MDF për veshjen e mureve, dhe dyert e brendshme. Ky profil garanton cilësinë teknike dhe estetike të punimeve me bazë druri, duke mbikqyrur procesin e prerjes, montimit dhe trajtimit të materialeve për të siguruar përshtatshmëri dimensionale dhe qëndrueshmeri sipas standarteve të ndertimit. Ky inxhinier siguron që materialet të jenë të trajtuara ndaj lagështisë, konsumimit dhe zjarrit, në përputhje me kërkesat teknike
  Referuar preventivit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e mësipërme i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

**2.3.6** Operatoret ekonomik pjesemarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e proceseve në këtë objekt, punonjësit e kualifikuar si më poshtë:

**2.3.6.1** – 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e

Shqipërisë, si dhe duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

**2.3.6.2** – 1 (nje) Punonjes të pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë", e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, shoqeri të licencuara/akredituara, ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***<u>Argumentimi:</u>*** Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"* si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

**2.3.6.3** – 1 (nje) Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te leshuar nga Drejtoria e MZSH, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***<u>Argumentimi:</u>*** Eksperti Zjarrfikës është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe sigurinë e personelit gjatë punimeve, veçanërisht në proçeset që përfshijnë


Sheshi "Musa Fratari" Këlcyrë E-mail:bashkiaekelcyres@yahoo.com

saldime, instalime elektrike dhe materiale të ndezshme. Ai siguron pajisjen e kantierit me mjete fikse, sinjalistike dhe rrugë evakuimi, në perputhje me VKM nr. 108, datë 15.02.2018 dhe standartet për sigurinë ndaj zjarrit.

**2.3.6.4** – 1 (një) Inxhinier Elektronik/IT, i cili të jetë i çertifikuar në nivel profesional për data network (të dhëna rrjeti) nga organizma te mirënjohura ndërkombëtare CISCO "CCNA/CCNP" ose ekuivalent. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë çertifikatën përkateëe si dhe duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***Argumentimi:*** Kërkesa për një specialist të tillë duhet pasi kemi të bëjmë me konfigurim, administrim dhe mirëfunksionimin e rrjeteve kompjuterike dhe pajisjeve IP, të cilat janë thelbësore për sistemet që do të instalohen. Duke qenë se objekti përfshin rrjete kompjuterike, kamera IP, pajisje POE, switch-e, sisteme alarmi dhe komunikimi të brendshem, ky inxhinier siguron që pas përfundimit të instalimeve fizike, pajisjet të konfigurohen dhe të funksionojnë në një sistem të unifikuar, pa nderprerje. Ai kryen parametrizimin e switch-eve, NVR-ve, servereve dhe router-ve, duke garantuar komunikim të qendrueshëm mes rrjeteve të të dhënave dhe pajisjeve.

**2.3.6.5** – 1 (një) Inxhinier/punonjës, të certifikuar si Koordinator Saldimi sipas standartit SSH EN ISO 14731 (ose ekuivalent), lidhur me koordinimin dhe menaxhimin e saldimeve (Detyrat dhe Pergjegjesite). Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese te lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***Argumentimi:*** Ky inxhinier eshte i domosdoshem ne fazen e zbatimit, pasi garanton qe te gjitha proceset e saldimit te konstruksioneve metalike te kryhen ne perputhje me standartet teknike dhe kerkesat e sigurise. Ne objektin qe perfshin ndertimin e palestres dhe shkalles se emergjences me konstruksion metalik, ky inxhinier ka rol kyc ne mbikqyrjen e procedurave te saldimit dhe kontrollin e cilesise se bashkimeve metalike, dhe qe cdo nyje metalike e salduar te kontrollohet per defekte sipas procedurave te inspektimit vizual jo-shkaterrues. Ne menyre qe i gjithe procesi i saldimit te quhet i certifikuar dhe me siguri maksimale nevojitet prania e nje koordinatori saldimi, duke qene se aktivitetik fizik dhe dinamik e levizjeve ne keto ambjente do te jete e vazhdueshme.

**2.3.6.6** – 1 (nje) Punonjës të çertifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit nga Instituti i Ndërtimit ose Inxhinier

Materialesh. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose diplomën universitare lidhur me profilin Inxhinier Materialesh, si dhe duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***Argumentimi:*** Kërkesa është vlerësuar e nevojshme si kërkesë teknike pasi objekti që do rikonstruktohet dhe ai që do të ndërtohet nga e para janë godina publike ku ka lëvizje dhe prani të shumtë të njerëzve dhe për këtë arsye materialet e përdorura duhet të jenë të garantuara sipas cilësisë dhe standarteve bashkëkohore.
Prandaj, testimi i besueshëm i materialit është metoda më e zellshme për të verifikuar se materialet e përdorura nga kompanitë në proceset e tyre të zbatimit do të përmbushin pritjet dhe do të përputhen me të gjitha rregulloret në fuqi.

**2.3.6.7** – 5 (pese) punonjes te trajnuar per punime ne lartesi te cilet te jene te pajisur me çertifikate “Per punime ne lartesi”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese certifikaten perkatese si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***Argumentimi:*** Kërkesa bazohet ne Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*, pasi në fazën e zbatimit parashikohen konstruksione metalike, montime në çati dhe punime fasadash që zhvillohen mbi nivelin e tokës dhe paraqesin rrezik të lartë për rënie apo dëmtime.

**2.3.6.8** – 2 (dy) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar si “Operues te kaldajave me avull dhe uje te nxehte” për instalimin dhe venien ne pune te paijsjes. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***Argumentimi:*** Prania e këtyre specialisteve është e domosdoshme për të siguruar instalimin e funksionimin e sigurt, të qendrueshëm dhe efikas të sistemit të ngrohjes, i cili përbëhet nga kaldajat e më lënde djegëse gaz dhe rrjeti i shpërndarjes së ujit të ngrohtë drejt radiatoreve. Duke qenë se kaldaja konsiderohet pajisje nën presion, kërkohet që instalimi dhe vënia në punë e saj të kryhet nga personel i trajnuar posaçërisht, në përputhje me kërkesat sipas *"Rregullores së sigurimit teknik te kaldajave te avullit dhe ujit te nxehte, Tirane 1988"* dhe ligjit Nr. 32/2016 “*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.*

Prania e këtyre operatorëve garanton se kaldaja do të vihet në punë dhe do të funksionojë në mënyrë të sigurt, duke shmangur rreziqet që lidhen me valvolat e sigurisë, mbinxehjen apo presionin e tepërt.

**2.3.6.9** – 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar si "Operues të rezervuarëve/ instalimeve të GLN-së me vëllim deri 13 m3 mbi/nën tokë" për përdorimin dhe instalimin e depozites/rezervuarit te gazit (2800 litra) sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 *"Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion"* dhe ligjit Nr. 32/2016 "*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion"*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

***<u>Argumentimi:</u>*** Kjo kërkesë bazohet në faktin se rezervuaret e gazit GLN/LPG, qofshin mbi tokë apo nën tokë, janë pajisje nën presion me rrezik potencial të lartë. Ata përmbajnë lëndë djegëse të kompresuar, që në rast manipulimi të pasigurt mund të shkaktojnë rrjedhje, shpërthime apo zjarre. Për këtë arsye instalimi dhe përdorimi i tyre mund të kryhet vetëm nga persona të trajnuar, që kanë njohuri lidhur me rregullat teknike të sigurisë, presionin e punës dhe procedurat e emergjencës në përputhje me VKM Nr. 1062, datë 23.12.2015 *"Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion"* VKM nr. 1067, datë 23.12.2015 *"Për pajisjet e gazit",* dhe ligjin Nr. 32/2016 "*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion"*

*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per stafin teknik si me siper, emer/mbiemer, profili i punes, numrin e amzës/regjistrit dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për stafin e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni lëshues i çertifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohen dhe te dhenat i identifikimit te institucionit privat).*

*(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)*

***Shënim:****Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*
*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional, certifikatë ose diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise" si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| - Teknik i Mesem Ndertimi | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik i Mesem Mekanik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik i Mesem Elektronik/IT | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik i Mesem Elektrik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Elektricist | 4 (kater) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Hidraulik | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Instalues/Specialist te sistemeve te ngrohjes | 2 (dy) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Karpentier | 3 (tre ) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Hekurkthyes | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Betonues | 4 (kater) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Murator / Suvatues | 7 (shtate) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Specialist veshje fasade | 4 (kater) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Pllakashtues | 4 (kater) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Shtrues/Montues per dysheme parketi | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Bojaxhi | 4 (kater) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Punëtor duro-alumini (per dritare/dyer) | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Specialist per punime Gipsi (Sistemet e thata) | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Saldator | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Pergatites te Konstruksioneve metalike | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Hidroizolues | 3 (tre) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Marangoz/Mobilier | 2 (dy) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Gurepunues/Gurgdhendes | 6 (gjashte) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome |
| - Shofer | 3 (tre) | Leje Drejtimi kategoria C minimalisht |
| - Eskavatorist | 2 (dy) | Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP) |
| - Automakinist | 2 (dy) | Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP) |

*(Në rastin kur makineritë disponohen me qera për shoferët dhe manovratorët nuk kërkohet disponimi i tyre në listpagesat e shoqërisë, pasi këto punonjës mund të kontraktohen.)*

*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numrin e amzës/regjistrit dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistët e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni lëshues i çertifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohet dhe NIPT-i).*

*Deshmite/Certifikatat/Diplomat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara/akredituara sipas legjislacionit ne fuqi persa i perket profesioneve te mesiperme, do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim.*

*Saldatoret e deklaruar si më sipër, duhet të jenë të kualifikuar/ çertifikuar sipas standardit SSH EN ISO 9606-1, sa i përket kërkesave për testimin dhe kualifikimin e saldatorevë për saldimin e çeliqeve, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërise.

*Njeri prej hidraulikeve te deklaruar si me siper, duhet te jete i kualifikuar/certifikuar sipas standardit SSH EN 13067, sa i përket kërkesave për saldimin e tubove me termoplastike, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërise.

*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për kualifikimet/çertifikimet si më sipër kerkohet, emër/mbiemër, numrin dhe daten e çertifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar kualifikimet/çertifikatat perkatese.*

*(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)*

***Shënim:****Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*
*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

***Argumentimi:*** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik",* Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "ç".Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar

| An | Shtrese me pllaka guri natyror Rsh>80Mpa (Rezistenca ne shtypje) | 2,975.00 | ore pune |

Në total 6216.84 ore pune gjithsej

(8 ore x 6 dite x 20 jave) = 960 orë pune në total për 20 jave (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

6216.84 orë pune : 960 orë pune në total për 20 jave = 6.48 Gurepunues/Gurgdhendes të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses

Duke qene se keto punime mund te zgjaten ne nje afat mesatarisht 20 javor (H. Rregullime dhe sistemime te jashtme dhe 14. Punime murature guri) sepse jane punime qe nuk ndikojne ne proceset e tjera te punes, njësia e prokurimit gjykon se 6 (gjashte) Gurepunues/Gurgdhendes eshte një numër minimal për zbatimin e ketyre punimeve me sukses.

Lidhur me kërkesën për Shofer 3 (tre), Eskavatorist 2 (dy), Automakinist 2 (dy),

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë drejtues për makineri të rënda për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamiona me kapacitet mbajtës mbi 12 ton 1 (një) copë, Kamion me kapacitet mbajtës deri në 12 ton (1) copë, K Kamioncine kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) për transportimin e mallrave të mësipërm pranë kantierit të ndërtimit, Rrul ngjeshës 1 (një) copë për ngjeshjen dhe sistemimin e oborrit të shkollës, Minieskavator 1 copë, Minidumper (me goma) 1 (një) copë, Grejder 1 copë etj .

Referuar volumit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të arsyeshëm manovratorësh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë

**2.3.8** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojne liçense te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Per grumbullim, ruajtje dhe transportim te mbetjeve inerte), në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës

Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3, si dhe Transport material ndërtimi, dheu me auto deri 10 km, dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 **"** Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë **"**, parashikohet se " Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj." Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivti, kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, pasi krahas punimeve të gërmimit, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e mbeteve urbane, transportin e dherave dhe inerteve, i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara .

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

**2.3.9** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojne certifikatat si me poshte:

- Certifikatën SSH/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të cilesise). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, **ose (**SSH/EN/UNI **ISO 45001:2023)** e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/EN/UNI **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese certifikatat ISO në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/EN/UNI** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërise.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO ( Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësise me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

- **ISO 9001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) **e vlefshme, *ose ekuivalent***

Për implementimin e Sistemit të Manaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës iso të mësipërme .

- **ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit" e vlefshme, *ose eikuvalent***

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .
Kjo çertifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të

drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambjentit përreth ku do të kryhet investimi.

- **ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) **e vlefshme,** ***ose ekuivalent***

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .
Kjo çertifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.
Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

- **ISO 50001:2011 ( Sistemi i Menaxhimit të Energjisë ) e vlefshme,** ***ose ekuivalent***

Kjo ISO përfaqëson standartin për menaxhimin e sistemit të energjisë dhe specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, ruajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është për të mundësuar një organizatë për të ndjekur një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumit të saj .

Në preventivin e punimeve të procedurës së prokurimit është parashikuar edhe kryerjen e punimeve elektrike si dhe punimeve për ngrohje. Referuar zërave të Preventivit parashikohet edhe furnizim vendosje e paisjeve elektrike si “kabuj, ndriçues, shtylla elektrike, panele të matjes së energjisë, automate etj.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatori ekonomik dhe prodhuesit e produkteve të ofruara prej tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Nga analiza e mësipërme konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e certifikatave standarte ISO të operatorëve ekonomikë dhe prodhuesit e produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, sipas fushave përkatëse të çertifikimit ISO (ISO 50001:2011 “Për menaxhimin e energjisë”) është një kërkesë proprocionale me objektin e prokurimit përsa kohë që në preventivin e punimeve të procedurës së prokurimit janë parashikuar kryerjen e punimeve elektrike. Kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk shkon përtej asaj çka është e nevojshme për të arritur synimin bazë, vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës

dhe prodhuesit e produkteve të ofruara prej tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit/cilësisë, në zbatim të LPP-së.

- Çertifikate ISO 3834-2: 2021 “Për sistemin e menaxhimit të cilesise në saldim” **e vlefshme, *ose ekuivalent***

Certifikata standarde Iso 3834 është një sistem i krijuar nga ISO në mënyrë që të specifikojë kushtet e përshtatshme të cilësisë bazuar në metodat e ndërmarrjeve prodhuese të saldimit, të cilat janë burimi i shkrirjes në materialet metalike, dhe për të siguruar praktikat e duhura të prodhimit dhe prodhimin cilësor.

Kjo certifikatë e cilësisë, e cila është certifikuar nga Iso 3834, Iso dhe emërtohet si certifikata ISO 3834, ka të bëjë me cilësinë e produkteve që mund të ndikohen nga burimet dhe prodhimi i burimeve që mund të veprojnë në sektorin e prodhimit. Certifikata Iso 3834 Ky dokument, i cili përcakton aftësinë e saldimit të prodhuesit i cili kryen punën e prodhimit në punët e prodhuara në fabrikë ose në terren, tregon cilësinë dhe ekspertizën e prodhuesit.

Me sistemin Iso 3834, efikasiteti i një produkti duhet të sigurohet gjatë prodhimit, jo përmes inspektimit. Për produktet që janë të lira nga problemet në prodhimin dhe kushtet e shërbimit, kontrollet duhet të kryhen nga përcaktimi i materialit gjatë procesit të projektimit deri në inspektimet pas-prodhuese. Për shembull, dizajni i dobët mund të krijojë probleme serioze dhe të kushtueshme në aplikacionin në seminar ose në terren. Përcaktimi i pasaktë i materialit ose kushtet negative të saldimit mund të shkaktojnë çarje të nyjeve. Për të siguruar një prodhim të shëndoshë dhe efektiv, menaxhmenti duhet të dijë burimet e mundshme të telasheve dhe të vendosë procedurat e duhura të cilësisë.

Referuar preventivit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se çertifikata e mësipërme i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e punimeve si Mbulim çatie me panele sanduich, F V konstruksione metalike te thjeshta, Rrethim i fushes se sportit me kolona metalike + rrjete teli etj, punime të cilat lidhen me saldimin e tyre në objekt sipas cilësisë Iso 3834.

**2.3.10** Numri dhe lloji i makinerive,paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

| Nr | Emri i mjetit | Njesi | Sasi | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kamion kapaciteti mbajtës mbi 12 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 2 | Kamion kapaciteti mbajtës deri në 12 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 3 | Kamioncine kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 4 | Autovinc | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 5 | Skela metalike | m2 | 1100 | Në pronësi ose me qera |
| 6 | Minifadrome | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 7 | Eskavator me goma | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 8 | Eskavator me zinxhir | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 9 | Gjenerator / Motogjenerator | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 10 | Autobetoniere | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 11 | Autopompe betoni / Pompe betoni | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 12 | Minieskavator | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 13 | Minidumper (me goma) | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 14 | Grejder | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 15 | Rrul ngjeshes | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 16 | Saldatriçe | copë | 3 | Në pronësi ose me qera |
| 17 | Trapan | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 18 | Nivelues me lazer | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 19 | Freze per rrafshim/hapje kanalesh ne mur | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 20 | Perzieres kolle/llaci | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 21 | Kompresor ajri | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 22 | Vibrator betoni | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 23 | Tokmak / Ngjeshes / Kompaktor | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 24 | Betoniere | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 25 | Pompe uji | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 26 | Pajisje niveluese shtresash | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 27 | Depozite uji 5000l | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 28 | Matrapik | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 29 | Pompe Suvatimi | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 30 | Makineri per kthim hekur ndertimi | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 31 | Total Station per rilevime matje/azhornime topografike | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.**

***a)*** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
***b)*** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme).
***c)*** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t΄i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.*

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdosshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje

me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

**Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :**

| Nr | Emri i mjetit | Njesi | Sasi/cope | ARGUMENTIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kamion kapaciteti mbajtës mbi 12 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) | Cope | 1 | Eshtë i nevojshëm për largimin e materialeve të dala nga prishjet e shkolës ekzistuese, si dhe transportin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit |
| 2 | Kamion kapaciteti mbajtës deri në 12 ton (sipas percaktimeve te Kodit Rrugor) | Cope | 1 | Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme ndërtimore, pranë kantierit |
| 3 | Kamion kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton | copë | 2 | Eshtë i nevojshëm për transportin dhe sjelljen në kantier të materialeve të ndryshme |
| 4 | Autovinc | copë | 1 | Eshtë i nevojshëm për shkarkimin e materialeve në kantier të materialeve të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ndryshme |
| 5 | Skela metalike | m2 | 1100 | Në pronësi ose me qera |
| 6 | Minifadrome | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 7 | Eskavator me goma | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 8 | Eskavator me zinxhir | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 9 | Gjenerator / Motogjenerator | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 10 | Autobetonier | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 11 | Autopompe betoni / Pompe betoni | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 12 | Minieskavator | copë | 1 | Eshtë i nevojshëm për punime gërmim kanalesh |
| 13 | Mini dumper (mjet teknologjik me goma) | copë | 1 | Eshte i nevojshem per transportin e materialeve te ndryshme nga vendi i grumbullimit apo blerjes deri ne objekt. Eshte tejet i nevojshem pasi kthehet lehte ne rruget e ngushta ku jo cdo mjet mund te aksesoje. Gjithashtu minidumperi do bej dhe transport materiale te dala nga germimi deri ne vendin e caktuar nga bashkia. |
| 14 | Grejder | copë | 1 | Eshte i nevojshem per hapjen dhe nivelimin e materialeve si cakell. |
| 15 | Rrul ngjeshes | copë | 1 | Eshte i nevojshem per ngjeshjen e cakellit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 16 | Saldatriçe | copë | 1 | Eshte i nevojshem per saldimin e shkalleve metalike |
| 17 | Trapan | copë | 2 | Eshte i nevojshem për punimet e prishjes. |

*Lidhur me pajisjet e tjera teknike, autoriteti kontraktor gjykon se janë të nevojshëm për mbarëvatjen e punimeve me sukses të objektit të kontratës.*

**2.3.11** Operatorët ekonomik ofertues per produktet/materialet/pajisjet si me poshte:

- Profile plastike per dritaret: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 477 *(përcaktimi i rezistencës në goditje të profileve plastike)*
- Profile per konstruksione metalike: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 10025-1 ose ekuivalente *(përsa i përket celikut te perdorur ne konstruksione metalike dhe elemente strukturore ndihmëse)*
- Boje hidroplastike (ekologjike): Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certifikate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të çertifikuar ku te vertetohet se produkti eshte ekologjik (EU ECO Label) ose ekuivalente
- Sistemi kapot (fasada me polisterol): Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 13499 ose ekuivalente *(ne perputhje me kërkesat teknike, karakteristikat dhe metodat e provës për sistemet e jashtme të izolimit termik të fasadave) që përdorin polisterolin si material izolues)*
- Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16 X 2.0) mm: Autorizimin e prodhuesit ose të distributorit zyrtar, të shoqëruar me katalogun dhe/ose skedat teknike të produktit, si dhe certifikatë që vërteton se tubat janë të sigurt nga ana higjeno-sanitare, të lëshuar nga organizma të akredituar
- Pllaka guri natyror Rsh>80Mpa: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin

**Komentoi [U1]:** Vlera eshte 4,944,795.17 Leke pa TVSH

**Komentoi [U2]:** Vlera eshte 6,738,344.63 Leke pa TVSH

**Komentoi [U3]:** Vlera eshte 2,514,318.61 Leke pa TVSH

**Komentoi [U4]:** Vlera eshte 5,485,392.9 Leke pa TVSH

**Komentoi [U5]:** Vlera eshte 1,461,500.00 Leke pa TVSH

SSH EN 1926 ose ekuivalente *(Metodat e provës për gurët natyrorë – Përcaktimi i rezistencës në shtypje)*

- Boje termoplastike (paste): Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 13036-4 ose ekuivalente *(per rezistencen ne rreshqitje ne terrenin sportiv)*
- Ndricues Projektor LED 50W dhe 100W: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 61547 dhe Direktiven 2014/30/BE *(lidhur me emetimet dhe shqetesimet elektromagnetike)*
- NVR smart dhe POE deri ne 16ch IP hyrje kamerash
- Switch i menaxhueshem Smart  me 16 Porta per POE, 1 porte per RJ45 dhe 1 porte per fiber optike
- Kamera te jashtme Bullet 5MP IP67
- Kamera te brendshme Dome 5MP IP67

  Duhet te paraqiten Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 50130-4 ose ekuivalente *(persa sistemeve te survejimit CCTV)*
- Element radiatori alumini ,kapacitet ne ngrohje per cdo element 110-135w: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 442 ose ekuivalente *(persa i perket standartit europian per ngrohjen me radiatore)*
- Kaldaje gazi me kapacitet 70 Kw: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 15502 ose ekuivalente *(përsa i përket sistemeve te ngrohjes me kaldaje gazi)* konform rregullores se Bashkimit Europian (EU) 2016/426 ne lidhje me pajisjet qe punojne me gaz
- Parket Druri: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SH EN 14342 ose ekuivalente (*përcaktimi i karakteristikat dhe kërkesat përkatëse të produkteve të dyshemeve dhe parketeve prej druri)*
- Panele Sandwich: Autorizim i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar, së bashku me katalogun dhe/ose skedat teknike përkatëse të produktit, si dhe certifikatë ose raport testimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, në përputhje me standardin SSH EN 14509 ose ekuivalente *(lidhur me kërkesat teknike, metodat e provës dhe kriteret e performancës për panelet sanduiç vetëmbajtëse me dy faqe metalike dhe bërthamë*

**Komentoi [U6]:** Vlera eshte 2,975,000.0 Leke pa TVSH

**Komentoi [U7]:** Vlera eshte 2,447,500.00 Leke pa TVSH

**Komentoi [U8]:** Vlera eshte 685,500.00 Leke pa TVSH

**Komentoi [U9]:** Vlera eshte 421,531.38 Leke pa TVSH

**Komentoi [U10]:** Vlera eshte 4,299,851.6 Leke pa TVSH

**Komentoi [U11]:** Vlera eshte 1,350,000.0 Leke pa TVSH

**Komentoi [U12]:** Vlera eshte 1,780,290.00 Leke pa TVSH

*izolimi termik (p.sh. poliuretan, lesh guri, PIR, etj.), të prodhuara në fabrikë dhe të përdorura për mure, çati dhe tavane në ndërtime)*

Komentoi [U13]: Vlera eshte 3,467,706.40 Leke pa TVSH

**Argumentim :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 8, si dhe", në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknikë, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, çertifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si : çertifikatë/deklaratë konfirmiteti**,** çertifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskrimininon midis operatorëve ekonomikë ofertues vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet dhe furnizimet që parashikohen të realizohen në preventiv, duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve bashkëkohore. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, në mënyrë që të provohet që operatori ekonomik ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.
Me anë të vënies në dispozicion në fazën e ofertimit të dokumentave si autorizim-marrëveshje angazhimi, skeda teknike, çertifikata cilësie, çertifikata konformiteti dhe raporte testimi, ofertuesi

garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë në përputhje sipas kërkesave të projektit.

**2.3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë kontratë bashkëpunimi ose shërbimi me një trupë inspektuese të akredituar sipas standardit ISO/IEC 17020:2012, nga një organ akreditimi kombëtar ose ndërkombëtar, që mbulon fushën e inspektimit dhe kolaudimit për kaldajen e gazit ne perputhje me SSH EN 303-7 ose ekuivalene *(Kaldaja për ngrohje - Pjesa 7: Kaldaja për ngrohje qëndrore me djegie gazi)* dhe per rezervuarin e gazit ne perputhje me SSH EN 12817 ose ekuivalene *(Inspektimi dhe rikualifikimi I rezervuareve te GLN)* pas procesit te instalimit te sistemit te ngrohjes.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë bashkëpunimi ose shërbimi me një trupë inspektuese, që mbulon fushën përkatëse të inspektimit teknik;
- Certifikatën e akreditimit të trupës inspektuese, të lëshuar nga një organ akreditimi kombëtar ose ndërkombëtar, në përputhje me standardin ISO/IEC 17020:2012, që vërteton kompetencën për:

– Inspektimin e kaldajave me gaz, në përputhje me SSH EN 303-7 ose ekuivalent (*“Kaldaja për ngrohje – Pjesa 7: Kaldaja për ngrohje qëndrore me djegie gazi”*);

– Inspektimin dhe rikualifikimin e rezervuarëve të gazit, në përputhje me SSH EN 12817 ose ekuivalent (*“Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të GLN”*).

Argumentimi : Qëllimi i autoritetit kontraktor është instalimi dhe vënia në punë e sistemit të ngrohjes. Ky instalim duhet ë kontrollohet nga një organ o pavarur inspektimi i cili garanton se kaldaja e gazit plotëson kërkesat e sigurisë, rezervuari i gazit (GLN) është i çertifikuar dhe i testuar për presion, si dhe sistemi i ngrohjes është instaluar dhe kolauduar në përputhje me standartet e BE-së.

Ligji Nr. 102/2014 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" përcakton standardet dhe masat që duhen marrë për të siguruar mjedise të sigurta pune. Ky ligj përfshin edhe rregullat për përdorimin e gazit dhe instalimin e sistemeve të ngrohjes që përdorin gaz, duke kërkuar që të gjitha instalimet të jenë të përshtatshme dhe të kalojnë kontrolle të rregullta për sigurinë.

Duke marrë parasysh faktin se kemi të bëjmë me rikonstruksionin e një shkollë, siguria fizike e nxënëse është primare për autoritetit kontraktor dhe vënia në përdorim e kaldajes duhet të kryhet nga persona/subjekte të çertifikuar sipas standartit SSH EN 303-7 ose ekuivalent, duke garantuar

Bashkinë Këlcyrë për zbatimin e punimeve me sukses dhe në përputhje me standartet bashkëkohere tëcilat rregullohen nga ligjet në fuqi.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e sipërcituar nuk shkon përtej asajt që është e nevojshme, por i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

Akoma më tej, plotësimi i këtij kriteri është lënë i hapur nga AK duke parashikuar edhe kontratë bashkëpunimi me subjektet e liçensuar.

**2.3.13** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë zyrtare, nëpërmjet së cilës shprehet dakordësia me mënyrën e financimit të objektit, si dhe angazhimi për përfundimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Kjo deklaratë kërkohet, duke qenë se financimi i objektit është parashikuar në buxhetin e viteve 2025–2027, ndërkohë që afati i realizimit të punimeve do të jetë në përputhje me grafikun e miratuar të punimeve nga autoriteti kontraktor.

***Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe "ekuivalentin" e tij/tyre.***

***Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/UNI/EN/ISO.***

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**


Sheshi "Musa Fratari" Këlcyrë E-mail:bashkiaekelcyres@yahoo.com